

VENDIM
Nr. 427, datë 26.6.2024

**PËR AUTORIZIMIN E AUTORITETIT PORTUAL DURRËS PËR TË
NEGOCIUAR DREJTPËRDREJT DHE PËR TË LIDHUR MARRËVESHJE
KONSULENCE ME SUBJEKT NDËRKOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, ‘Për prokurimin publik’”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Autoritetit Portual Durrës për të negociuar drejtpërdrejt dhe për të lidhur marrëveshje konsulence me subjektin ndërkombëtar “*Royal Haskoning DHV*”, brenda fushës së kompetencës së saj, një fushë me interes strategjik për proceset e konkurrimit, kontraktimit, ndërtimit dhe mbikëqyrjes së portit të ri të integruar të Durrësit në Porto-Romano.
2. Ky autorizim qëndron në fuqi jo më shumë se 3 (tre) vjet nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 16/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, ‘Për prokurimin publik’”.
3. Ngarkohet Autoriteti Portual Durrës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama